

## PËRZGJEDHJA E GUVERNATORIT TË DISTRIKTIT-TË NOMINUAR-PËRCAKTUAR (DGND)

### Fletëvotimi i klubit për D 2485 me procedurë votimi online

Procedura e Votimit të Klubit për emërimin e DGND 2027 - 2028 u miratua nga përfaqësuesit e klubeve, pjesëmarrës në Mbledhjen e Legjislacionit në Tiranë më 16 qershor 2024.

Duke qenë se procedura e votimit online është përdorur me sukses për procesin e Votimit për Klubet në përzgjedhjen e tre guvernatorëve të parë të distriktit tonë, ne kemi vendosur të miratojmë dhe të vazhdojmë ta përdorim këtë metodë për zgjedhjet e ardhshme.

Orari për zgjedhjet e Distriktit 2485 për Guvernatorin e Distriktit 2027 – 2028 është si më poshtë:

Ngjarja	Koha	Data
1. Guvernatori i distriktit fton klubet të paraqesin sugjerimet e tyre për nominimet për guvernator.		03.01.2025
2. Afati i fundit për sugjerime nga klubet.	Të paktën një muaj pasi guvernatori dërgon njoftimin	03.02.2025
<i>Nëse sugjerohet vetëm një, guvernatori deklaron kandidatin e vetëm të jetë guvernatori-i/e nominuar-përcaktuar</i>		
3. Kur sugjerohen dy ose më shumë kandidatë, guvernatori njofton të gjitha klubet për emrat dhe kualifikimet e tyre, duke treguar se guvernatori-i/e <i>nominuar-përcaktuar</i> do të zgjidhet në një fletëvotim të klubit.		04.02.2025
4. Guvernatori njofton çdo klub për numrin e votave për të cilat ka të drejtë siç thuhet në seksionin e Kodit të Politikave të Rotary 17.040.4.	Të paktën 15 ditë para votimit	05.02.2025
5. Guvernatori përgatit dhe i dërgon çdo klubi një fletë votimi, të nënshkruar nga anëtarët e komisionit të votimit. Numri i votave të një klubi përcaktohet nga formula në aktet nënligjore të RI seksioni 15.050.1., bazuar në faturën e klubit të datës 1 korrik.		20.02.2025
6. Afati për kthimin e fletëve të votimit tek guvernatori i distriktit	Jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 30 ditë pas dërgimit të fletëvotimit	08.03.2025
7. Guvernatori shpall vendin, datën dhe orën e numërimit dhe vleftësimit të votave dhe cakton një komision prej tre anëtarësh për kryerjen e këtyre detyrave.	Përcaktohet nga guvernatori	20.02.2025 Kur fletëvotimi u dërgohet klubeve

8. Në prani të kandidatëve ose përfaqësuesve të tyre, komisioni i votimit vlerëson fletët e votimit të hedhura. Më pas, në një proces të veçantë, komisioni i votimit numëron fletët e votimit. Komiteti i votimit i raporton menjëherë rezultatet e votimit te guvernatori, duke përfshirë numrin e votave të hedhura për secilin kandidat.		09.03.2025
9. Guvernatori njofton kandidatët dhe të gjitha klubet për rezultatet e zgjedhjeve, duke shpallur kandidatin që ka marrë shumicën e votave si guvernator- <i>i/e nominuar- përcaktuar</i> .		10.03.2025
10. Komisioni i votimit i ruan të gjitha fletët e votimit për 15 ditë dhe i vë në dispozicion për inspektim nga çdo përfaqësues i klubit. Fletët e votimit asgjësohen pas një periudhe 15-ditore, përveç nëse ka një ankesë zgjedhore.	Për 15 ditë pas njoftimit të kandidatëve nga guvernatori	25.03.2025
11. Guvernatori vërteton emrin e guvernator- <i>it/es – të nominuar-përcaktuar</i> duke dorëzuar formularin e guvernator- <i>it/es – të nominuar- përcaktuar</i> në CDS..	Brenda 10 ditëve pasi guvernatori shpall rezultatet	17.03.2025